



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 8, datë 30. 03. 2009

PËR

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 20,
DATË 26.04.2002 MBI “FINANCIMIN E KUOTËS SË ANËTARËSIMIT
TË QYTETIT TË TIRANËS NË SHOQATËN BOTËRORE TË
KRYEQYTETEVE FRANKOFONE”**

Në mbështetje të kreut III, neni 8, pika 1/V, shkronja “b”; të kreut V, neni 15, pika 5 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe VKB-së nr. 20, datë 26.04.2002 mbi “Financimin e kuotës së anëtarësimit të qytetit të Tiranës në shoqatën botërore të kryeqyteteve frankofone”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 26.04.2002 mbi “Financimin e kuotës së anëtarësimit të qytetit të Tiranës në shoqatën botërore të kryeqyteteve frankofone”, të ndryshohet si më poshtë:

- fjalët “për vitet 2003, 2004, 2005, 2006 (kuotë e përcaktuar nga sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës)”, zëvendësohen me fjalët “për vitin 2003 dhe në vazhdim”.
2. Shpenzimet për kuotën e anëtarësimit për efekt të pikës 1 dhe shpenzimet e detyrimeve të pashlyera prej 2,248.82 Euro (dy mijë e dyqind e dyzetë e tetë Euro e tetëdhjetë e dy Cent)”, të përballohen nga fondi i aparatit të Bashkisë së Tiranës, i miratuar në buxhetin e saj.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R